



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA KOMERCIALE  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

---

**K.DH.SH.II.nr.990/22**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Santafarm” SHPK, me seli në Prishtinë, Nr. biznesit ..., të cilën me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “...”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë - Inspektorati Shëndetësor, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr. 342/19, të datës 13.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.09.2023, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Ministria e Shëndetësisë - Inspektorati Shëndetësor, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr. 342/19, të datës 13.10.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr. 342/19, të datës 13.10.2021, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Santafarm SHPK, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë - Inspektorati Shëndetësor. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit është anuluar aktvendimi i të paditurës, Ministria e Shëndetësisë - Inspektorati Shëndetësor nr.10/FR-013-18 i datës 28.12.2018 dhe vendimi nr.05-4671 i datës 11.08.2015, ashtu që paditësi është liruar nga detyrimi i pagesës së gjobës së shqiptuar. Me pikën III të dispozitivit është vendosur që Në lidhje me kompensimin e dëmit pala paditëse udhëzohet në kontest civil. Ndërkaq me pikën IV të dispozitivit secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale. Me pikën V të dispozitivit të aktgjykimit është vendosur që aktgjykimi ta zëvendëson aktin e anuluar dhe ka karakter të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura përmes Avokaturës Shtetërore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr. 342/19, i datës 13.10.2021 dhe të refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit ashtu që të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Kolegji i Dhomave së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit administrativ - aktvendimit të paditurës Ministria e Shëndetësisë - Inspektorati Shëndetësor nr.10/FR-013-18 i datës 28.12.2018 dhe vendimi nr.05-4671 i datës 11.08.2015. Përmes padisë paditësi ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës nr.10/FR-013-18 datë 28.12.2018 mbi shqiptimin e gjobës në shumë prej 1000 eurove, dhe që paditësi të lirohet nga obligimet për pagesën e gjobës, duke kërkuar shpenzimet e procedurës. Në padi ka theksuar se me nenin 13 të Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale është përcaktuar në paragrafin 10 që AKPPM si institucion përgjegjës publikon në baza mujore listën e barnatoreve të licencuara përmes të cilës listë operatorët ekonomik që operojnë në tregun me shumicë sikurse paditësi në këtë rast do të mund të informoheshin mbi barnatoret të cilat janë të licencuara dhe ato që nuk janë. Në rastin konkret AKPPM nuk ka publikuar listën asnjëherë me barnatoret e licencuara sipas nenit 13 paragrafi 10 të Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale. Për këtë fakt paditësi nuk ka pasur mundësi objektive që të dijë se barnatores Valerianae M1 i është pezulluar licenca, pas lëshimit të saj për çka edhe paditësi nuk ka pasur mundësi të informohet për këtë fakt. Për këto arsye ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, ta anulojë vendimin e inspektorati shëndetësor nr. 10/FR-013-18 të datës 28.12.2018.

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, në prani të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të palës së paditur, dhe pasi ka vlerësuar vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, duke vendosur që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit, si në aktgjykimin e kontestuar.

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë me provat e administruara, konstatohet gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga këtu e paditura, për faktin se e njëjta vendimin e saj dhe pretendimin e bazon në furnizimin e subjektit pa pasur licencë pune, kurse e njëjta me asnjë provë nuk e ka dëshmuar dhe argumentuar se në çfarë bazë ky subjekt vepron në mënyrë ilegale, me cilat veprime është konstatuar se e njëjta vepron ilegal, gjykatës nuk i është ofruar asnjë provë me të cilën do të mbështetej zhvillimi i ndonjë procedure lidhur me pezullimin e licencës apo anulimin e saj, përderisa gjykata kishte në shkresa të lëndës licencën L5/2012/120851 për barnatoren në fjalë me afatshmëri 5 vjeçare

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, këtë qëndrim juridik të gjykatës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore

(LPK). Lidhur me vendosjen si në aktgjykim, gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka dhënë konstatimet faktike lidhur me parregullsitë ligjore të gjetura në aktgjykimin e goditur me ankesë nga e paditura.

Në rastin konkret, duke iu referuar shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës të cilat gjykata i heton sipas detyrës zyrtare, Kolegji nuk gjeti shkelje të natyrës absolute të cilat shpijnë në prishjen e aktgjykimit. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i kuptueshëm, nuk ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe nuk ka asnjë rrethanë kontradiktore të cilat eventualisht do ta bënë aktgjykimin të përfshihet me shkelje absolute të dispozitave procedurale. Rrjedhimisht, Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se aktgjykimi është i ekzaminueshëm dhe mund të ekzekutohet dhe si i tillë nuk është i përfshirë me shkelje nga Neni 182 par.2 pikat g), j), k), m), të cilat Gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare.

Në anën tjetër duke iu referuar pretendimeve në ankesë, Kolegji nuk gjeti asnjë pretendim të vetëm ankimor që i referohet shkeljeve esenciale, përpos pretendimeve të përgjithësuara se provat nuk janë vlerësuar drejtë dhe se aktgjykimi është bazuar në thëniet e përfaqësuesit të paditësit. Një pretendim i tillë është i paargumentuar, ngase nuk është përcaktuar qartë se cilat prova nuk janë marrë parasysh dhe se cilat prova të paditurës kanë vërtetuar gjendje tjetër të fakteve, të cilën gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se i takon të paditurës që t'i ngritë qartë pretendimet e veta për shkeljet konkrete kur thirret në shkelje relative të dispozitave të procedurës.

Kolegji vlerësoi se këto pretendime nuk janë të bazuara dhe të argumentuara në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe në dispozitat ligjore në fuqi, ngase aktgjykimi i ankimuar rrjedh se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjithashtu Kolegji, konsideron se gjykata e shkallës së parë, ka zbatuar drejtë ligjin material, respektivisht dispozitat e Nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr.13/2013 me të cilin përcaktohet se *“5.Qarkullimi me shumicë i produkteve dhe pajisjeve medicinale duhet të shpërndajë produktet medicinale vetëm për qarkulluesit shumicë dhe pakicë të licencuar nga autoriteti kompetent, institucionet shëndetësore publike dhe institucionet shëndetësore private të licencuara”*. Ndërkaq me Nenin 13 të Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale është përcaktuar në paragrafin 10 që AKPPM si institucion përgjegjës publikon në baza mujore listën e barnatoreve të licencuara përmes të cilës listë operatorët ekonomik që operojnë në tregun me shumicë sikurse paditësi në këtë rast do të mund të informoheshin mbi barnatoret të cilat janë të licencuara dhe ato që nuk janë. Rrjedhimisht edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë nga gjykata e shkallës së parë kur ka konstatuar se në rastin konkret AKPPM nuk ka publikuar listën

asnjëherë me barnatoret e licencuara sipas nenit 13 paragrafi 10 të Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale, në mënyrë që paditësi të kishte barrën për të mos shitur produkte medicinale tek pala e tretë që në rastin konkret ishte barnatore pa licencë. Në këtë drejtim, Kolegji gjen se aktgjykimi i atakuar mbështetet në dispozitat ligjore, ku drejtë janë vërtetuar faktet se në vendimin kontestues të paditurës, paditësi pa të drejtë është ngarkuar me gjobë për veprimet e pretenduara se ka shkelur dispozitat ligjore pa pasur përgjegjësi.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II.nr.990/22 datë 29.09.2023**

**Kryetar i Kolegjit, gjyqtari**  
**Dren Rogova**